



VENDIM

Nr. 87, Datë 09.06.2016

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “E - VENTO S.R.L ALBANIA” SHPK,
PËR SHTYRJEN E AFATEVE TE LICENSES NR. 60, SERIA NPM08,
“PER NDERTIMIN, INSTALIMIN, SHFRYTEZIMIN DHE
PRODHIMIN E ENERGJISE ELEKTRIKE NGA CENTRALE
EOLIKE”, TE DHENE ME VENDIMIN NR. 84, DATE 17.07.2008, I
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, gërma “a” të Ligjit 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë të Elektrike” Nenit 5 dhe 6, të “Rregullores për Procedurat e Heqjes së një Liçense, neneve 16 pika 2 dhe 18 të Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE miratuar me vendimin nr 21, datë 18.03.2009, i ndryshuar gërma, “a”, “d”, “e” të Vendimit nr. 84, date 17.07.2008 të Bordit të Komisionereve të ERE-s, pikës 1.2; 1.6 dhe 1.7 të kushteve të liçensës Nr .60, Seria NPM08 dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 84, datë 17.07.2008, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 09.06.2016, mbasi shqyrtoi informacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE në licencën e shoqërisë “E-Vento s.r.l. Albania” sh.p.k,

Konstatohet se:

- Duke mbajtur në konsideratë rëndësinë e investimit dhe me qëllim mbështetjen dhe nxitjen e ndërtimit të Burimeve të Rinovueshme të Energjisë ERE ka pranuar kërkesat e shoqërisë “E-VENTO Srl Albania” sh.p.k në lidhje me shtyrjen e afateve për realizimin e projektit duke përfshirë këtu edhe kolaudimin e veprës.
- ERE ka miratuar shtyrjen e afateve me vendimet :
 - Vendimin e Bordit të Komisionereve Nr. 63, date 22.09.2009,
 - Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 55, datë 25.08.2010,
 - Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 134, datë 15.11.2013,

- Me shkresën me Nr. 171 Prot., date 20.02.2015, shoqëria “E-VENTO Srl Albania” sh.p.k, ka paraqitur një kërkesë tjetër për shtyrjen e afateve të licensës së ndërtimit të dhënë me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s me nr. 84, datë 17.07.2008, i ndryshuar së fundmi me vendimin Nr. 134, date 15.11.2013.
- Mospërbushja e parashikimeve të pikës 1 gërma “e” të vendimit nr. 84 datë 17.07.2008, i ndryshuar e bën licencën të pavlefshme.
- Kur nuk përmbushen kushtet thelbësore të licencës së dhënë, sipas ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, ERE me iniciativën e vetë mund të heqë licensën.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Rrezimin e kërkesës së shoqërisë “E-Vento s.r.l Albania”sh.p.k, për zgjatjen e afatit të licensës Nr .60, Seria NPM08 dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 84, datë 17.07.2008, për ndërtimin, instalimin, shfrytëzimin e Centraleve Elektrike dhe prodhimin e energjisë elektrike nga Parku Eolik Sarandë.
2. Fillimin e procedurave për heqjen e licensës së shoqërisë “E Vento s.r.l Albania “ sh.p.k, Nr .60, Seria NPM08 dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 84, datë 17.07.2008.
3. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI